



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**

**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU, TEHNOLOGIJU I INOVACIJU  
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY & INNOVATION**

*Prishtinë, 12.10.2021*

**Përgjigje në pyetjet e OJQ-ve lidhur me thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale.**

**Pyetje:**

1. Pyetja ime është a mundemi ne si OJQ- shoqata e sportit shkollor të marrim persiper punën me persona me aftësi të kufizuara për Komunen [REDACTED] Rrjedhimisht edhe me ata femije që kanë aftësi të jashtëzakonshme në Sport.

2. Kemi një pyetje në lidhje me aplikimin për subvencione për ojq.

Ne kemi shoqatën e pedagogëve të sportit shkollor, dhe pyetja jonë është se a kemi të drejtë të aplikojmë për këto subvencione në lidhje me zbulimin e talentëve në sport, problemet psikosociale dhe personat me aftësi të kufizuara apo vetëm për njërin kemi të drejtë. Edhe nëse mundëne me na dergu udhëzuesin dhe formularët për aplikim. Ju falemnderit

**Përgjigje për pyetjet 1 dhe 2:**

1. Bazuar në pyetjen tuaj dhe bazuar në thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale, ju njoftojmë se të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen dhe promovimin e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale.

2. Të gjitha materialet e nevojshme për aplikim janë në web faqen e MASHTI-t.

## Pyetje:

3. Shpresoj te jeni mire. Po ju shqetsoj ne lidhje me thirrjen publike te dates 1.10.2021 ne lidhje me "Thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psikosociale."

3.1 Nuk mujta mi gjet dokumentet e kerkuara ne faqen zyrtare.

3.2 Dhe a perfshihen keto tema qe mund te pefitojne mbeshtetjen financiare:

- - Regjistrimi i nxenesve, te disa shkollave publike (ku mesimi vijohet ne te tre gjuhete lokale) ne Biblioteken e Qytetit [REDACTED]
- - Blerja e librave per te burgosurit ne Qendren Korrektuese [REDACTED] u denimin e vuajne te miturit dhe te burgosurat dhe paraburgosurit ne Qendren e Paraburgimit ne [REDACTED]
- - Ofrimi i mesimit TOEFL per super-nxenesit te kombesive dhe feve te ndryshme qe jetojne ne [REDACTED] te cilit deshirojne m'i viju studimet jasht vendit?

## Përgjigje:

3.1. Të gjitha materialet e nevojshme si: thirrja publike për OJQ, udhëzuesi për aplikim si dhe formularët janë të vendosura në web faqen e MASHTI-t ( [www.masht.rks-gov.net](http://www.masht.rks-gov.net) ).

3.2. Sa i përket nënpyetjes së dytë ju lutem referojuni udhëzuesit për aplikim të vendosur në web faqen e MASHTI-it, pika 2.3, pika 2.4, pika 2.4.1, pika 2.4.2, pika 2.4.3,

## Pyetje:

4. Përsëndetje shpresoj që jeni mirë! Deshta të pyes rreth thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psikosociale, tek kriteret që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e veprimtarisë së OJQ-së, aty ceket që OJQ-ja duhet të ketë së paku një vit veprimtari. Ne si OJQ kemi veprimtari që nga viti 2019, mirpo të rexhistruar si OJQ në MKRS jemi nga Gushti i këtij vititi 2021. Kjo preiudha dy vjeqare e gjysmë a llogaritet si veprimtari, apo vetëm prej momentit të rexhistrimit, që për ne korespondon data 13 Gusht 2021? Pyetja ime e radhës është, si është i rregulluar kriteri rreth llogarisë bankare, në këtë thirrje të hapur publike?

## Përgjigje:

4. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike. Po ashtu, kërkohet "përvojë të paktën 3 vjeçare në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publik".

Nën pyetja 2 e pyetjes 4, si është i rregulluar kriteri rreth llogarisë bankare, në këtë thirrje të hapur publike (nuk e kemi të qartë qfarë po kërkohet konkretisht me këtë pyetje) bazura në udhëzuesin e aplikimit potencohet qartë se OJQ-të duhet :

- ✓ Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- ✓ Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
- ✓ Të mos ketë shkelur kushtet e parashikuar të përdorimit të fondeve publike.

**Pyetje:**

5. Une, [REDAKTUAR] jam drejtues i nje ojç lokale qe ne tetor te ketij viti shenon nje vit te themelimit, pyetja ime eshte: Si eshte mundesia e aplikimit per thirrjen e hapur nga MASHT ne lidhje me perkrahjen edhe promovimin e nxenesve me aftesi te kufizuar dhe mbeshtetje psiko-sociale, sepse aty kerkohej minimum 3 vite pervoje.

**Përgjigje:**

5. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike po ashtu në Udhëzuesin e Aplikimit i cili gjendet ne web faqen e MASHTI-t pika 2.1 **Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj,** pika 3- përcakton se OJQ-ët duhet të kenë përvojë të paktën 3 vjeçare në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike.

**Pyetje:**

6. Pershendetje! Jam nga organizata OJQ [REDAKTUAR] nuk po mundem me apliku sepse formulari nuk me lejon te shkruaj, kam provuar ne disa laptope pr eshte i njejti problem, ju lutem mund te me ndihmoni?

**Përgjigje:**

6. Të gjitha materialet e nevojshme lidhur me këtë thirrje janë të vendosura në web faqen e MASHTI-t ([www.masht.rks-gov.net](http://www.masht.rks-gov.net)), dhe janë funksionale për t'u plotësuar.

**Pyetje:**

7. Pershendetje, [REDAKTUAR]  
Kohëve te fundit kam pa një thirrje ne lidhje me projekte për fëmijë qe kanë dhunti te veçanta. Deshta me ju pyet a lejohen individet te aplikojn ne kete projekt nese po ju lutem me dergo materialin qe duhet plotesuar per aplikim.

**Përgjigje:**

7. Bazuar në pyetjen tuaj dhe bazuar në thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që **përkrahin dhe promovojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nxënësit me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale,** ju njoftojmë se të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës programi i punës së të cilave është i fokusuar në ndonjërin nga fushat e ndërlidhura me përkrahjen dhe promovimin e nxënësve me aftësi të

kufizuara, nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti si dhe nxënësit që kanë nevojë për mbështetje psikosociale.

**Pyetje:**

8. Pershendetje e nderuar,

Jam e interesuar të aplikoj për “Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ”. A mund të më dergoni ndonjë link ku mund të aplikoj?

**Përgjigje:**

8. Të gjitha materialet e nevojshme lidhur me këtë thirrje janë të vendosura në webfaqen e MASHTI-t ( [www.masht.rks-gov.net](http://www.masht.rks-gov.net) ), dhe janë funksionale për t'u plotësuar.

**Pyetje:**

9. E nderuar,

Uroj që ky email të ju gjej mirë. Kam një pyetje për ju në lidhje me piken 2.1 të thirrjes, se kush mund të aplikoj me projekt. Kerkoj nga ju që të na sqaroni se për nënpikën:

3. Të kenë përvojë të paktën 3 vjeçare në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike;

A vlenë për organizatën dhe aktivitetet e saja të mëhershme apo për stafin që është i angazhuar në projektin të cilin do ta dorëzojë organizata për aplikim, si dhe në çfarë forme duhet të vërtetohet ky angazhim nëse vlenë për organizatën?

Mëqenëse kjo pikë organizatën tonë e diskualifikon nga kjo thirrje edhe pse organizata jonë është përfituese e mëhershme e dy projekteve me karakter të ngjashëm të thirrjes tuaj. Këto projekte i kemi realizuar në përpikmëri e korrektësi brenda afatit dhe objektivave të kërkuara.

Qendra [redacted] ka në fokusin e saj veprimtarinë arsimore dhe edukative dhe për ne kriteri i lartëcekur përben një kriter eliminues, pasi që 3 vite përvojë nuk deshmojnë korrektësi e as cilësi me të lartë se ne, në zbatimin e projekteve. Stafin ynë është i përgatitur profesionalisht dhe me përvojë disa vjeçare në fushën e arsimit.

Mbesim me shpresë që ky kriter të mos na diskualifikon nga kjo thirrje dhe nga vullneti jonë për të kontribuar në aktivitete me karakter arsimor-edukativ, mëqenëse themelimi i kësaj organizate është bërë para një viti e gjysmë me vullnetin tonë të plotë për të kontribuar në këto pika.

Ju faleminderit!

[redacted]

**Përgjigje:**

9. Pika 3 për të cilën keni kërkuar sqarime vlen për organizatën (OJQ-n), me të cilën konkurrioni sepse për këto subvencione konkurrohet si OJQ dhe jo si individ.

## **Pyetje:**

**10.** Jemi nga organizata qeveritare [REDACTED] e cila eshte themeluar me 12.06.2013 ku ne vitin e themelimit kemi realizuar disa projekte per kurse te gjuhes angleze dhe te informatikes, kryesisht per personat e verber apo ata me shikim te demtuar. Pershkak te angazhimeve tona ne jeten studentore organizata per disa vite ka qene pasive dhe nuk ka kryer asnje aktivitet ne gusht te vitit 2020 kemi riaktivizuar organizaten. Ne si OJQ kemi nevojte per nje qartesisim sa i perket kesaj thirrje publike.

Thirrje projekte OJQ-ve për nxënësit me aftësi të kufizuara, talente, dhe dhunti ne piken 3. Të kenë përvojë të paktën 3 vjeçare në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike; duke u bazuar ne informatat e lartcekura ne organizaten tone kerkojme nga ju qe te na qartesonit ose pergjigjeni ne kete pyetje a kemi te drejte ne si ogranzizat qe te aplikojme ne kete thirrje, dhe sa jane gjasat reale sipas te dhenave te pershkruara me larte qe te jemifitues posesial me nje projekt propozim ne kete thirrje Me shpres se do te marrim nje pergjigje te shpejt nga ju. Me respekt [REDACTED] drejtor ekzekutiv [REDACTED]

## **Përgjigje:**

**10.** Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike po ashtu në Udhëzuesin e Aplikimit i cili gjendet ne web faqen e MASHTI-t pika 2.1 Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj, pika 3- përcakton se OJQ-ët duhet të kenë përvojë të paktën 3 vjeçare në implementimin e projekteve nga fushat prioritare të thirrjes publike.

## **Shënim:**

Për të qenë sa më transparent pyetjet janë paraqitur si në strukturë dhe përmbajtje ashtu si janë adresuar nga kërkesat e palëve ndërsa përgjigjet janë përgatitur nga MASHTI.